

Pyetje dhe përgjigje për Sistemin ISO-Massivhaus

"Si është klima e banimit në një shtëpi ISO-Massivhaus?"

Klima në kthinat e një shtëpie të ndërtuar me sistemin ISO - Massivhaus, është e mrekullueshme sepse:

Për një mjedis të shëndoshë dhe të këndshëm banimi, ndryshimi në mes të temperaturës së ajrit dhe mureve, është kondita dominante. Nëse muri për 3°C është më i ftohtë se ajri, atëherë ekziston ndjenja jo e këndshme se në dhomë ka shkuj, kështu që ndjenja nuk është e mirë dhe jo e shëndetshme. Muret e brendshme të ISO-Masivmuret, edhe në temperatura ekstreme (jashtë minus 20°C, b rinda plus 20°C) vetëm max. 1°C nga temperatura e ajrit mund të jetë ndryshimi. Kështu ISO-Masivmuri siguron një ambient të këndshëm të banimit dhe një klimë të shëndetshme dhe të pranueshme.



"Sa gjatë qëndron Styropori / Neopori?"

Styropor® është një emër i dëgjuar nga prodhuesi BASF AG. Shënimi dhe emërimi i përgjithshëm, edhe për prodhues tjerë është: **-Expandirte - Polystyrol- Shkuma e fortë, shkurimisht "EPS"**.

Prej vitit 1994, kemi edhe një material të ri me emër Neopor®. Neopor-Elementet ripërpunohen edhe me një proces tjetër teknologjik me avull të ngrohtë dhe dallohen nga ngjyra e përhitë që kanë.

EPS përdoret qysh nga 1951. Hulumtimet kanë vërtetuar se ky material edhe pas shumë viteve nuk ka shenja të dëmtimit apo "plakjes".

"A është EPS dëmtues i shëndetit?"

Jo. EPS punohet me shkuma e përpunuar me avull uji dhe përbëhet nga ajri në masë prej 98%. Është apsolutisht i pa helmueshëm, madje përdoret edhe për paketim të ushqimit. EPS ka përdorim të gjërë në jetën e përditshme dhe ka tregues të mjaftueshëm që e vërtetojnë mosrrezikshmërinë e këtij materiali për shëndet.

(Foto: Paketim ushqimi nga styropori. Burimi: Fotolia)



"A digjet EPS?"

Jo. Pë ISO – Shtëpitë Masive (Elementet e ndërtimit) përdoret materiali i kalses "SE" që do të thotë: Vështirë djeget, dhe vetë shuhet (Nga gjermanishtja Schwer entflammbar und selbstverlöschend).

"A është betoni biologjikisht i pa rrezikshëm?"

Po. Vetitë biologjike të betonit ja dëshmuar para shumë viteve, andaj nuk keemi qfarë të shtojmë më shumë.

"Ç'është në të vërtetë betoni?"

Betoni është një "guri i lëngshëm", të cilin e njëfishin edhe romakët e vjetër. Ai përfitohet nga rëra, zhavorri, uji dhe çimentoja. Çimentoja përfitohet nga psh.rëra gëlqerore, Toni (Zgjura) guri i gipsit etj. Per informata tjera konsulto literaturen apo vizitoni: www.beton.de

"A ka mundësi të ndërtohen edhe banesat shumëkatëshe me këtë sistem ndërtimi?"

Po ! Deri në 22 m lartësi të objektit (Niveli maksimal i dyshemesë së katit të fundit) sistemi ISO – Massivhaus është i lejuar për përdorim, e nëse sistemi punon si sistem skeletor ndërtimi, lartësia mund të jetë akoma më e madhe.



"A mund të përdoret sistemi i ngrohjes qendrore i dyshemesë te kjo formë ndërtimi?"

Po sigurisht se mund të përdoret, madje me sukses, sepse humbjet do të jenë shumë të vogla.

"Ku do të mund të gjendet ky sistem i ndërtimit?"

Ne do të ndërtojmë për ju në tërë hapësirën e Kosovës eventualisht edhe në Shqipëri dhe Maqedoni. Elementet e neoporit, sipas nevojë mund të ju liferojmë edhe në vende tjera.

"ISO-Massivhaus: A është ndërtimi më i shpejtë në botë?"

Punimi i mureve bëhet shumë shpejt meqë kemi të bëjmë me elemente të mëdha dhe të lehta.

Mirëpo ne dëshirojmë të jemi realist, punimet tjera, si pllakat, suvatimi, instalimet elektrike të ujit etj. kanë kohëzgjatje ndërtimi të njëjtë si të sistemet tjera të ndërtimit, një lehtësim i theksuar është të instalimet elektrike, meqë nuk ka nevojë të thyhen kanalet për kabllot në murë, që mendojmë se nuk është pak. Është e qartë se ndërtimi kërkon kohën e vet!..

Nëse premtohet se në pak javë ju ndërtojmë shtëpinë me qelësa në dorë, atëherë pyeteni vehten: **Seicili ka dëshirë të afaroj, por askush s'mundet ta bëjë këtë me shkop magjik!**

Disa gjëra duhet të presin: Suvatimi i brendshëm, nivelizimi i dyshemeve duhet të thahet para se të vazhdohet me fazat e tjera si ngjyrosja apo tapetimi i mureve, vendosja e pllakave të keramikës apo parketit, përkatësisht laminatit.

Ndërtimi "me qelësa në dorë" nuk nënkupton edhe finesat, disa gjëra ju ngelen juve si investitor, siq është rregullimi i brendshëm meqë kjo është qështje e shijes. Rregullimi i banjove, përzgjedhja e ngjyrave, lloji dhe dizajni i keramikave, sanitarisë së banjos, llusterëve, spinave, ndërpresëve, perdeve etj. të cilat nuk i përkasin ndërtimit me qelësa në dorë, vetëm nëse precizohen me kontratë që në shumicën e rasteve është me shpjegime dualiste dhe të komplikuar.